



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

nr. 57 Prot.

Elbasan, më 27 . 01 . 20

**RREGULLORE**  
**PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR**  
**MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË BASHKINE ELBASAN**

**KREU I**  
**RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Elbasan, bazohet në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr. 60/2016.
5. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
6. “Organizatë” është autoriteti publik ose subjekti privat.
7. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.
8. “Sinjalizues” është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
9. “Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
10. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

KREU II  
VEPRIMET PROCEDURALE

**Neni 4**

**Kryerja e veprimeve procedurale**

1. Veprimet procedurale të Njesise pergjegjese kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njesia pergjegjese cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

**Neni 5**

**Konfidencialiteti**

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm ose të jashtëm, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë organizatës ose ILDKPKI-së, si edhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. Njësia Përgjegjëse, në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrative ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.
4. Çdo person i cili merr informacion konfidencial nga njësitet përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për qëllim të këtij ligji, ka të njëjtin detyrim për përpunimin e informacionit në mënyrë konfidenciale.

KREU III  
HETIMI ADMINISTRATIV

**Neni 6**

### **Parimet e përgjithshme të hetimit administrativ**

1. Njësia përgjegjëse duhet të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interes legjitim të sinjalizuesit.
2. Njësia përgjegjëse duhet të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave.
3. Njësia përgjegjëse duhet të shmangë çdo konflikt interesi të mundshëm dhe të deklarojë menjëherë tek organizata ose ILDKPKI-ja konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrative të një sinjalizimi.
4. Ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi.
5. Ruajtja e sekretit shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi në zbatim të ligjit.

### **Procedura e hetimit administrative**

#### **Neni 7**

#### **Procedura e hetimit administrativ**

1. Njësia Përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.60/2016.
2. Gjatë periudhës së hetimit administrative, njësia përgjegjëse shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Për këtë qëllim njësia ka të drejtë të kërkojë informacion dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklaratat ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt ligjor.
4. ILDKPKI-ja duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej saj.

#### **Neni 8**

#### **Mosfillimi dhe përfundimi i hetimit administrativ**

1. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrative në rastet e përcaktuara në ligjin nr.60/2016 nëse;
  - a: sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 7 i ligjit nr.60/2016.
  - b: sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, sipas nenit 3, pika 6, të ligjit nr.60/2016
  - c: kur nga përmbajtja sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes

Administrative ose të veprës penale.

2. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse;  
a.gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar.

b.sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit,në zbatim të nenit 6 të ligjit Nr.60/2016.

#### **Neni 9**

##### **Mbrojtja kundër hakmarrjes**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korupsioni,në përputhje me dispozitat e ligjit nr.60/2016,mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës,për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës,organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë.

#### **Neni 10**

##### **Raportimi dhe Bashkëpunimi**

1. Njësia përgjegjëse zaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit dhe i paraqet ILDKPKI-së jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës,raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara,mënyrat e ndjekura për hetimin administrativë të sinjalizimeve dhe mbrojtjes e sinjalizuesëve.
2. Në zbatim të ruajtjes së konfidencialitetit,sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale,njësità përgjegjëse bashkëpunojnë më njëra-tjetrën dhe me ILDKPKI-në për shkëmbim të dhënash,të plota dhe pa asnjë rezervë,me qellim shqyrtimin dhe zgjidhjen e një rasti të sinjalizuar,ku pavarësisht nga organizata e sinjalizuesit,të sinjalizuarit i përkasin organizatave të ndryshme.

#### **KREU IV**

##### **AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT**

#### **Neni 11**

##### **Masat në përfundim të hetimit administrativ**

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësia përgjegjëse e një autoritetit publik ose ILDKPKI-ja rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative sipas ligjit,njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja,sipas rastit vë në dijeni organin kompetent.
2. ILDKPKI-ja dhe organizata në bashkëpunim me ILDKPKI-në,marrin masa të

menjëhershme,të çastit dhe për aq sa është e mundur,për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

## **Neni 12**

### **Afati i përfundimit të hetimit administrativ**

Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur por në çdo rast,jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit,përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

**Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.**

MIRATOI  
KRYETARI  
GLEDIAN LLATJA

